



Npi – 01/150 datë: 27.04.2023

Në mbështetje të nenit 11, dhe nenit 12.2 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008); Nenit 12.3, të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636, datë 03.09.2008; Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr.02/2019 për Organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane; Rregulloren e (MAPL) Nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës; Si dhe duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në komunën e Shtimes, Npi – 01/381 datë: 28.11.2022. Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 27.04.2023 mori këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR NDIHMË NË ZGJEDHJEN E PËRFAQËSUESVE TË FSHATRAVE DHE LAGJEVE URBANE

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IV- të rregullt për vitin 2023, të mbajtur më: 27.04.2023, me shumicën e votave miratoi vendimin për formimin e Komisionit prej 7 anëtarëve, për të ndihmuar në procesin e zgjedhjes të Këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane në komunën e Shtimes, në këtë përbërje:

1. Adnan Ademi.....Kryesues i Kuvendit,
2. Reshat Mujota.....Kandidat i pavarur,
3. Adem Ramadani.....Përfaqësues nga subjekti PDK,
4. Anita Kurti.....Përfaqësuese nga Ekzekutivi,
5. Rrezartë Ramadani.....Përfaqësuese nga LDK-AKR,
6. Fatlum Rexha.....Përfaqësues i OJQ-ve, (më vërejtjen që nevojitet konfirmim nga OJQ)
7. (Emri e mbiemri)Përfaqësues i zgjedhur ad-hoc nga fshati, lagja-urbane.

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Anëtarëve të Komisionit, Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi